



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS**

Date.07.11.2018

SHTOJCË

MBI MODIFIKIMIN DHE NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE STANDARTE TË TENDERIT

Sot më datë 07.11.2018, Njësia e Prokurimit ju bën me dije se:

Në bazë të Nenit 63 pika 1/1, të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78, pika 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), procedura : “Kerkese me propozim” e prokurimit me nr.REF – **91387-10-24-2018**, me objekt: “**Ndërtim I rruges Kalaja Petralb, rikonstruksion rruga Gurre e Vogel dhe ndertim ure Lela -Arriku**” , me fond limit: **6.500.000** lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Klos për vitin 2018, është pezulluar si rezultat i paraqitjes së ankimit të bërë nga operatori ekonomik “**Vllaznia Ndertimi I.S**”shpk në lidhje me Dokumentat Standarte të Tenderit.

Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Klos**, ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore në lidhje me trajtimin e ankimit

Në vijim, Autoriteti Kontraktor ka konkluduar me pranimin e ankesës.

Njësia e Prokurimit, si rezultat i pranimin të ankimit nga Grupi i Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me dokumentat e tenderit vendosi të bëjë ndryshimet përkatëse në Dokumentat Standarte të Tenderit për procedurën e prokurimit me objekt “**Ndërtim I rruges Kalaja Petralb, rikonstruksion rruga Gurre e Vogel dhe ndertim ure Lela -Arriku**” si më poshtë vijon:

❖ Në pjesën Kriteret e Veçanta të Kualifikimi, Kapaciteti teknik **pika 2.3.4.**

• Eshte kerkuar:

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar minimalisht 1 (nje) Teknik Ndertimi kjo të vërtetohet me:

- Kontratën individuale të punës;

- Liçense profesionale ne zbatim nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
- Librezë pune

BËHET

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar minimalisht 1 (nje) Teknik Ndertimi kjo të vërtetohet me:

- **Kontratën individuale të punës;**
- **Diplome.**

Ju lutemi operatorëve ekonomikë që do të paraqesin ofertat e tyre për këtë procedurë të marrin për bazë Shtojcën mbi modifikimin dhe ndryshimin e Dokumentave Standarte të Tenderit në platformen elektronike të APP –së.

Sa më sipër Njësia e Prokurimit në mbështetje të Nenit 42 pika 2 dhe pika 2/1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe në bazë të Kreut VII , Neni 62 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar) vendosi të bëjë ndryshimet në dokumentat e tenderit përmes hartimit të një shtojce e cila u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik duke u bërë detyruese për ta.

Nisur nga ky fakt, Njësia e Prokurimit në mbështetje të Nenit 42 pika 2/1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe në bazë të Kreut VII , Neni 62 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar) vendosi të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 (pesë) ditë kalendarike.

Njësia e Prokurimit njofton të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës se afati kohor për dorëzimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt: **“Ndërtim I rruges Kalaja Petralb, rikonstruksion rruga Gurra e Vogel dhe ndertim ure Lela -Arriku “**, është si më poshtë vijon:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:
Data: 12.11.2018, Ora: 10:00

Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, www.app.gov.al

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:
Data: 12.11.2018, Ora: 10:00

Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, www.app.gov.al

NJËSIA E PROKURIMIT

